



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesues i KD-së
Prof. dr. Ismet Salihu

Nr. Prot.: 58
Datë: 11 / 1 / 2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina, me kërkesë nr. 16, të datës 04.01.2018 të Parlamentit të Studentëve, rishqyrtoi pikën II të Vendimit nr. 3/910 të datës 27.12.2017 mbi lartësinë e bursës Universitare për studentë të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2017/18, në mbledhjen e mbajtur më 11.01.2018 dhe mori:

V E N D I M

për plotësim- ndryshim të pikës II të vendimit nr. 3/910 të datës 27.12.2017

Pika II e vendimit bazik nr. nr. 3/910 të datës 27.12.2017 ndryshohet si në vijim:


- I. Lartësia e bursës universitare për vitin akademik 2017/18, për çdo përfitues do të jetë 600 euro, shumë e cila ndahet për rezultatet e arritura gjatë vitit akademik 2016/17. Bursa ndahet për periudhën e studimeve, përkatësisht për 10 muaj të vitit akademik.
- II. Pikët tjera të vendimit bazik nr. 3/910 të datës 27.12.2017, mbesin të pandryshuara.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës pasi shqyrtoi kërkesën nr. 16, të datës 04.01.2018 të Parlamentit të Studentëve, lidhur me Pikën II të Vendimit nr. 3/910 të datës 27.12.2017, që ka të bëjë me lartësinë e bursës Universitare për studentë të Universitetit të Prishtinës, për vitin akademik 2017/18, konsideroi se duke pasur parasysh mjetet e kufizuara buxhetore të parapara për subvencione nga të cilat bëhet pagesa e bursës universitare për studentë që arrijn t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara me konkurs për të qenë përfitues të bursës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Për publikim në Ueb-faqe të UP-së,
3. Njësive akademike të UP-së,
4. Shërbimit financiar të UP-së,
5. Zyrës Ligjore të UP-së .

Këshilli Drejtues i UP-së

Prof. Dr. Ismet Salihu - Kryesues
